



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	Nr. i Prot. Prot. No.
Nr. i Faqeve Br. Stranica	Data: Date:
No. Pages	
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.01-011/01-19353 për caktimin e parces për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, miratuar nga KK Gjakovë

I nderuari Kryetar, Gjini,
I nderuara Kryesuese, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 03.08.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.01-011/01-19353 për caktimin e parces për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, miratuar nga KK Gjakovë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës :

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr.01-011/01-19353 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, miratuar nga KK Gjakovë, datë 28.07.2022.

Arsy et i m i

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit Nr.01-011/01-19353 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, miratuar nga KK Gjakovë, konstatoi se:

- Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj;
- Nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzim tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor (pjesën tekstuale dhe pjesën grafike) në fuqi sipas Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të mirret vendim i drejtë dhe i ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2022

Dt. 28.07.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 dhe 16 të Ligjit nr.04/L-147 për Planifikimin Hapësinorë, në nenin 14 pika b të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.07.2022, pas diskutimeve lidhur me pikën e 3 të Rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit për caktimin e parcelës me numër P-70705077-00949-2, Z.K, Firëz, për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, e miratoi këtë :

V e n d i m

Për

caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë.

1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, në pjesën e parcelës me numër P-70705077-00949-2, Z.K, Firëz.
2. Kisha Rilindja e Kosovës në Gjakovë, do të ndërtohet në pjesën e Parcelës me numër P-70705077-00949-2, Zona Kadastrale Firëz, në sipërfaqe prej 10000m².
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

4.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration	Numri i Dokumentit Doc. No. 3706-2/22
Numri i Dosës File No. -02	Data Date 18.07.2022
PRISHTINË / A No. 1	

HYRESE - IBLAZNA - INCOMING		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration		
Data Date 18.07.2022		
Niveli i Organizatës Level of Organization	Nr. i Lendës No. of Pages 020-566/4	Vlera Value

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbenesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor Data: 04.07.2022
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Fisnike Kelmendi, Zyrtare Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimin nr. 011/01-16585 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë datë 29.06.2022 miratuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë

I nderuari Kryetar, Gjini,
E nderuara Kryesuese, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 01.07.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin nr. 011/01-16585 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë datë 29.06.2022 miratuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Gjakovës:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimin nr. 011/01-16585 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë datë 29.06.2022 miratuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit nr. 011/01-16585 për caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë datë 29.06.2022 miratuar nga Kuvendi Komunal Gjakovë, konstatoi se:

Preambula nuk është referuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, gjithashtu Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj;

Meqë nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor pjesën tekstuale dhe pjesën grafike në fuqi sipas Ligji Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor duhet patjeter të shikohet lokacioni i planifikuar sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi.

Vendimi si i tillë ka të meta sepse në arsyetim të aktit nuk jepen arsyet nëse parcela kadastrale ku pretendohet të ndërtohet është në harmoni me dokumente të planifikimit hapësinor në fuqi.


Andaj, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI dhe Kuvendi Komunal i Gjakovës të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 Të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. 011/01-16585 /2022

Dt. 29.06.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040, nenin 41 pika a dhe h të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2022, pas diskutimeve lidhur me pikën e 5 të Rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e parcelës me numër P-70705077-00949-2, Z.K, Firëz, për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, e miratoi këtë:

V e n d i m

Për

caktimin e parcelës për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë.


1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, në pjesën e parcelës me numër P-70705077-00949-2, Z.K, Firëz.
2. Kisha Rilindja e Kosovës në Gjakovë, do të ndërtohet në pjesën e Parcelës me numër P-70705077-00949-2, Zona Kadastrale Firëz, në sipërfaqe prej 10000m².
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

4.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Arbënesha Kuqi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Datë:	20.07.2022
Numër:	07-zyrtarë
Për:	Kryetarin e Komunës, z. Ardian Gjini
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Gjakovë, Udhëhe. sek .Elida Bejtullahu inxh.dip ark.
Përmes:	Drejtori: Arben Bakalli <i>Bakalli</i>
Lënda:	Njoftim lidhur me planifikimin hapësinor


I/Të nderuar,

Bazuar në kërkesën për prezantimin e të dhënave hapësinore – urbane lidhur me parcelën kadastrale ndërtimore me numër P-70705077-00949-2 Z.K. Firzë, për pjesën ku është planifikuar ngritja e objektit për shërbime të komunitetit të Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, Ju njoftojmë me sa vijon.

Parcela kadastrale- pjesë, ku është planifikuar ngritja e objektit për shërbime të komunitetit të Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, përfshihet në zonën urbane - zonën brenda kufijve urban të qytetit e përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor si Planin Zhvillimor Komunal / Vendimi i miratimit me numër prot. 01Nr.011/01-11250/2022 datë 05.05.2022. Sipas të njëjtit Plan Zhvillimor Komunal (neni 15 i Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor) në cilësinë e planit strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor – Hartës së shfrytëzimit të tokës (Harta nr.10,11 dhe 12) parcela – lokacioni i përket zonës së planifikuar për shfrytëzim të hapësirës për zhvillim të infrastrukturës publike dhe sociale e emërtuar si : Zonë rekreacioni dhe turizmi dhe tangjenton – është në kufi dhe në shërbim të zonës banimore e cila e kufizon të njëjtën.

Meqë Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik dhe nuk zbërthen e trajton planifikimin e shfrytëzimit dhe kushtet e zhvillimit në nivel zone dhe parcele :

Sipas dokumentit hapësinor pasues dhe derivues nga Plani Zhvillimor Komunal si Harta Zonale e Komunës (Neni 16 i Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor) në cilësinë e dokumentit multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës, hapësira ku përfshihet parcela me numër P-70705077-00949-2 Z.K. Firzë e kualifikuar si zonë rekreacioni dhe turizmi sipas Hartës së Shfrytëzimit të tokës, zona është zbërthyer në Zonë rekreacioni (ZRT nomenklatura sipas UA MMPH 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor —shtojca normat teknike të planifikimit hapësinor -kapitulli 4) ku në shfrytëzimet e lejuara (UA MMPH 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për



hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës , neni 29, paragrafi 1.1-1.9) është e planifikuar – lejuar përveç aktiviteteve tjera dhe aktivitete të komunitetit dhe ato fetare.

Me dokumentin hapësinor Hartën Zonale të Komunës, Komuna në kuadër të zonës në fjalë ka planifikuar dhe përfshirë në plan zhvillimin e objektit të shërbimit të komunitetit të Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lokacionin e ndarë për ngritjen objektit për shërbime të komunitetit të Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë e konsideron në përputhshmëri me dokumentin hapësinor si Planin Zhvillimor Komunal meqenëse i njëjti ka të përcaktuar vetëm zhvillimin e zonës e jo të aktiviteteve të cilat mund të zhvillohen në zonë, element ky i cili definohet në dokumentin si Harta Zonale e Komunës . Po ashtu, caktimi i lokacionit është në përputhshmëri dhe në funksion të zonës dhe aktiviteteve të lejueshme në zonë dhe do të jetë në zbatim të të njëjtës me rastin e miratimit final të dokumentit hapësinor- Hartës Zonale të Komunës.

Me respekt!

Bashkangjitur:

- Ekstrakt nga Ortofotogrametria për vendndodhjen e parcelës kadastrale;
- Ekstrakt nga Planin Zhvillimor Komunal- Harta e shfrytëzimit të tokës;





